



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Shëndetësisë</i> Z. Imet Rrahmani	DATE DATUM DATE	21.03.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Njomza Emini, Deputete e GP-LDK <i>N. Emini</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Unë si deputete kam pranuar shqetësime dhe ankesa të shumta nga disa punonjës arsimor si dhe punëtor shëndetësor se kjo dukuri është shqetësuese pasi që kemi rritje të numrit të përdoruesve të drogave pra nxënës të shkollave fillore dhe shkollave të mesme.

Pyetja: Andaj pyetja për ju Ministër, Ministri e Shëndetësisë pse jo edhe Ministria e Arsimit, a keni ndonjë strategji apo kampanjë si masë preventive për këtë dukuri negative.Pasi që të gjithë neve e dimë se sa kushton trajtimi i një narkomani i cili ka përdorur këto substanca narkotike.

Pra ju si Ministri a keni statistika të narkomanëve përdorues, numrin e përdoruesve , gjininë dhe moshën e tyre. Po ashtu a është menduar që të kemi kampanja apo masa preventive për këtë dukuri?

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</i>	DATE DATUM DATE	22.03.2016
NGA / OD / FROM	<i>Deputeti, Bekim Haxhiu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje për përgjigje me gojë</i>		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

I nderuari z.Ministër

Me projektbuxhetin e vitit 2015 kanë qenë të planifikuara mjetet buxhetore për fillimin e punimeve për stadiumin nacional, vazhdimin e punimeve për renovimin e stadiumit Adem Jashari dhe vendosjen e reflektorëve. Gjatë vitit 2015 nuk filloi puna në asnjërin nga këto stadione, mjetet buxhetore nuk u shfrytëzuan për qëllimin që i votoi Kuvendi i Kosovës.

Me projektbuxhetin e vitit 2016 janë paraparë investimet në stadiumin e Prishtinës dhe të gjithë adhuruesit e futbollit po presin me padurim fillimin e punimeve në këtë stadium, punime të cilat nuk pritete të përfundojnë në këtë vitë as vitin e ardhëshëm.

PYETJE :

I nderuari Ministër:

Pasi që stadiumi i Prishtinës ndodhëet në fazën e renovimit, stadiumi Adem Jashari nuk ka përfunduar, stadiumi nacional nuk ka filluar pyetja është, në shtatorë të këtij viti kur FFK pritete të tëluaj lojë të kualifikuese për Kampionatin Botëror, ku do të luhen ato?